



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR CAKTIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 12, QARKU LEZHË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATES 30.06.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 10.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr. 12, Qarku Lezhë, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1563 prot., datë 20.03.2019, i është drejtuar Prefektit të Qarkut Lezhë, duke kërkuar paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të Qarkut Lezhë që përmbushin kriteret e neneve 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015. për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për katër (4) Zonat e Administrimit Zgjedhor.

Prefekti i Qarkut Lezhë, me shkresën nr. 2892/1 prot, datë 05.04.2019, i ka paraqitur KQZ-së propozimet për ambiente të cilat mund të shërbejnë si Vende të Numërimit të Votave për VNV-të e këtij Qarku.

Ambienti i propozuar për krijimin e VNV-së për ZAZ-në Nr. 12, Qarku Lezhë, është:

1. Gjimnazi "Hydajet Lezha", me sipërfaqe 400 m<sup>2</sup>;



**Nr. 275 i Vendimit    Data 10.05.2019 e Vendimit    Ora 11:00 e vendimit**

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.12, Qarku Lezhë,  
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Ky ambient ka qenë Vend i Numërimit të Votave edhe në zgjedhjet e mëparshme, ndodhet brenda brenda territorit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor si dhe të Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit".

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

### **V E N D O S I**

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 12, Qarku Lezhë, në Gjimnazin "Hydajet Lezha", Bashkia Lezhë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

**Klement ZGURI Kryetar**

**Denar BIBA Zëvendëskryetar**

**Bledar SKËNDERI Anëtar**

**Edlira JORGAQI Anëtare**

**Rezarta BITRI Anëtare**



**Nr. 275 i Vendimit Data 10.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e vendimit**

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.12, Qarku Lezhë,  
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019